



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

U0161072

**ATTESTATION BY THE PRESIDING OFFICER PURSUANT TO RULE
92 BIS(B)**

I, RAM DORAISWAMY, Presiding Officer appointed by the Registrar of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia on 11-04-2007 pursuant to Rule 92 bis of the Rules of Procedure and Evidence, with the assistance of a certified interpreter, certify;

that on 21-04-2007 in GJAKOVË

the following person appeared:

Witness's First and Last name(s): ARIM SYLEYMANI

Date and Place of Birth: 19-01-1948 in PONORC

Identity-, or Passport No.: UNMIK ID CARD NO: 1001375551

Habitual Residence: GJAKOVË

- that in the attached statement dated 13/08/2006 and certified by the undersigned on 21/04/2007 the said witness is identified as the author;
- that the above-mentioned witness was provided with a version of the said statement in a language that he (~~she~~) understands;
- that the above-mentioned witness was informed, in a language that he (~~she~~) understands, by the Presiding Officer that if the contents of the written statement are not true to the best of his (~~her~~) knowledge and belief then he or ~~she~~ may be subject to proceedings for giving false testimony;
- that the above-mentioned witness was provided with a text of Rule 91 of the Rule of Procedure and Evidence, in a language he (~~she~~) understands;

Rule 92 bis

9


- that above-mentioned witness declared that the content of his (her) written statement are true and correct to the best of his (her) knowledge and belief;
- that no pressure was brought to bear on the witness and that he (she) voluntarily signed the attached declaration dated 21-04-2007 ;
- that the following persons were present during the said declaration:
 - MR. SHAZADA SULTAN - INVESTIGATOR
 - MR. GLIN ZIU, - INTERPRETER
 - MR. RAM DORAISWAMY - PRESIDING OFFICER
 - MR. AGIM SYLES MANI - WITNESS

Additional remarks:

• TOTAL NO. OF PAGES CERTIFIED: 9

Done this 21st day of APRIL 2007
 At GJAKOVË

Signature of the Presiding Officer




Rule 92bis

8

Deklarata e dëshmitarit Agim SYLEJMANI

**TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR PËR NDJEKJEN PENALE TË
PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS
HUMANITARE NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-
JUGOSLLAVISË PREJ VITIT 1991**

DEKLARATA E DËSHMITARIT

TË DHËNA MBI DËSHMITARIN:

Mbiemri: SYLEJMANI

Emri: Agim

Emri i mesit: N/A

Nofka/Alias: N/A

Emri i babait: Emrush

Datëlindja: 19.01.1848

Gjinia: Mashkull

Vendlindja: Parnoc

Origjina etnike: Shqiptar i Kosovës

Feja: Islame

Profesioi i tanishëm: Elektroauto

I mëparshmi: I njëjti

Gjuha (gjuhët) e folur: Shqip

Gjuha (gjuhët) e shkruar: E njëjtë me gjuhën e folur

Data e intervistës: 13 gusht 2006

Vendi i intervistës: Gjakovë

Intervistues: Tetyana LAZARENKO

Përkthyes: Ilir ZIU

**Gjuha (gjuhët) e përdorura
gjatë intervistës: Shqip dhe anglisht**

**Personat e pranishëm gjatë intervistës: Agim SYLEJMANI, Tetyana LAZARENKO,
Ilir ZIU**

Nënshkruar/inicialet:

1

të tjerë të pranishëm: nënshkrim

U015-3481-U015-3486-AT/es

Agim



7

Deklarata e dëshmitarit Agim SYLEJMANI

F.M.

DEKLARATA E DËSHMITARIT


1. Kam ardhur këtu me vullnet të lirë për të dhënë një deklaratë para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë (TPNJ). Nuk më kanë kërcënuar apo detyruar të vij këtu, nuk më kanë premtuar gjë, dhe nuk më kanë dhënë ndonjë stimul që ta bëj këtë. Më kanë thënë se, në rast se ndonjeri prej personave për të cilët do të flas në këtë deklaratë do të akuzohet nga TPNJ-ja, emri im mund t'u bëhet i njohur avokatëve mbrojtës të të akuzuarve dhe publikut të gjerë. NUK jam i gatshëm të dëshmoj para TPNJ-së në Hagë, Holandë, por e kuptoj se në rast se më kërkohet të dëshmoj, Gjykata do të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për mua. Nuk pranoj që një kopje e kësaj deklarate t'i jepet Policisë së UNMIK-ut, apo ndonjë agjencie tjetër të zbatimit të ligjit, që merret me hetimin e akuzave të krimeve të luftës të kryera në Kosovë gjatë konfliktit të fundit.
2. Jam lindur m fshatin Parnoc, Komuna Klinë. Kam patur një vëlla – Afrim SYLEJMANIN dhe tre motra – Sakibe Lota, Muzaqet RUSTA, dhe Hazbije KATONA. Dy motra – Sakibe dhe Hazbija – jetojnë këtu në Gjakovë, kurse motra Muzaqet ka kohë që jeton në Gjermani. Vëllai i vetëm që kisha, Afrimi u zhduk në 1998.
3. Në Gjakovë jetoj me time shoqe – Bekrije – vajzën, Doruntina, dhe djalin Ilir. Djali tjetër, Adonisi, jeton në Sh.B.A. Djali tjetër Florent u vra më 7.05.1999 në moshën 13-vjeçare nga forcat serbe në Gjakovë.
4. Në vitin 1998, im vëlla, Afrim SYLEJMANI banonte në Gjakovë me të shoqen Nashiden dhe me katër fëmijë – dy djemtë, Vetonim dhe Visarin, dhe dy vajza – Valdrinën dhe Valentinën. I biri i tij, Vetoni, vazhdon të jetojë ende me të jëmën, Visari punon në Prishtinë, Valdrina është martuar dhe jeton me të shoqin, kurse Valentina është e pamartuar dhe jeton në Gjakovë me të jëmën.
5. Gjatë 1998, në Gjakovë kishte forca serbe gjatë gjithë kohës. Nuk kam parë ndonjë prani të UÇK-së në Gjakovë, por ishin në fshatrat përreth dhe nëpër male. Kisha dëgjuar se Shtabi i UÇK-së ish vendosur në fshatin Gillogjan, por nuk e dija se kush ishte komandanti. Personalisht nuk jam futur asnjëherë në UÇK, dhe gjatë tërë kohës kam qëndruar në Gjakovë me familjen time.
6. Aty rreth marsit apo prillit 1999, djali im i madh Adonisi donte të futej në UÇK, por më në fund nuk u fut sepse nuk e lashë unë. Nuk kish as armë, as përgatitje ushtarake, ishte vetëm 16 vjeç. Gjatë luftës, nuk pata asnjë të afërm në UÇK.
7. Në 1998, vëllai im, Afrim SYLEJMANI, punonte privatisht si hidraulik në Gjakovë dhe në vende të tjera përreth, ku ia donte puna. Nuk ishte në UÇK,

Nënshkruar/inicialet:

2

të tjerë të pranishëm: nënshkrim

U015-3481-U015-3486-AT/es




Rule 92bis

6

Deklarata e dëshmitarit Agim SYLEJMANI

dhe asnjëherë nuk e kisha dëgjuar të fliste për UÇK-në. Banonte shumë larg meje dhe shiheshim ndoshta një herë në tre muaj.

8. Përpara 1998, Afrimi punonte si mësues i edukimit fizik në shkollën fillore të Dujakut. Në prill 1998, u vranë pesë fëmijë shkolle pranë kufirit me Shqipërinë. Nuk e di nga cili fshat ishin, por Afrimi i njihte disa syresh, sepse i kish patur nxënës gjatë kohës që jepte mësim në shkollë.
9. Mora pjesë në varrimin e tyre bashkë me Afrimin. Nuk e mbaj mend se në cilin fshat u bë varrimi, por ishte dita që Afrimi la shtëpinë për të mos u kthyer më kurrë, ishte 26 prill 1998.
10. Pas varrimit, po ktheheshim në shtëpi. Nuk më kujtohet se sa qe ora, por kish rënë nata. Po vinim me makinën e Afrimit, një Opel Corsa, nuk ia di numrin e targës, por ishte targa e Gjakovës. Mendoj se ngjyra e veturës ishte e kuqe, por nuk jam i sigurtë.
11. Gjatë rrugës Pejë-Gjakovë, përpara se të futeshim në Gjakovë, na ndaloi një patrullë policie serbe në pikën e kontrollit. Në atë kohë, në të gjitha hyrjet dhe daljet e Gjakovës kishte postblloqe serbe. Ata na kontrolluan dokumentat dhe na lanë të kalonim. Nuk na kërkuan para dhe nuk mbaj mend që vëllai t'u ketë ofruar t'i qiraste me birrë. Afrimi foli me policët serbë dhe nuk mbaj mend për se biseduan.
12. Pastaj me çoi me makinë në shtëpinë time dhe iku. Më tha se edhe ai në shtëpi do të shkonte. Ishte hera e fundit që e shihja vëllanë gjallë. Nuk më kish thënë kurrë se kish dëshirë të futej në rradhët e UÇK-së dhe nuk e di ku shkoi pasi më la mua tek shtëpia.
13. Pas rreth një jave, motra ime, Hazbije, më tha se e shoqja dhe fëmijët e Afrimit kishin shkuar në shtëpinë e saj të rrinin me të, sepse Afrimi qe larguar prej shtëpisë. Nuk më tha se ku kish shkuar, dhe nuk kam asnjë ide se ku mund të shkonte. Di vetëm se ish larguar me makinën e tij. Makina nuk është gjetur ende.
14. Nuk e pyeta të shoqen e Afrimit se ku mund të kish vajtur. Po ashtu, nuk dola ta kërkoja, sespe nuk kjo ishte punë e sigurtë në atë kohë. Përreth kish luftë dhe policia kërkonte gjithnjë t'i tregoje emrin e personit që po kërkoje. Dëgjova vetëm disa thashetheme prej njerëzve të tjerë se kish shkuar në UÇK. Nuk mund të them emrin e personit nga i cili i dëgjova këto fjalë sespe ishin fjalë që qarkullonin.
15. Në përgjigje të pyetjes nëse e di se Shtabi i UÇK-së ishte vendosur në Jabllanicë, mund të them se e kisha dëgjuar në radio, por nuk dija asgjë për të, apo se kush ishte komandanti.

Nënshkruar/inicialet:

U015-3481-U015-3486-AT/es

3


të tjerë të pranishëm: nënshkrim

Rulo 92 bis



5

Deklarata e dëshmitarit Agim SYLEJMANI

16. Më pas, takova të shoqen e Afrimit, Nashiden, dhe ajo më tha se Afrimi ishte në UÇK. Pas lufte, ajo nuk e raportoi atë si të humbur për një kohë të gjatë, dhe unë nuk e pyeta më për Afrimin, kështu që nuk e di arësyen përse e shoqja e Afrimit e raportoi atë si të zhdukur me kaq vonesë, por ajo më tha se nuk kish dashur të shqetësonte fëmijët.
17. E di se pas lufte, e shoqja e Afrimit, Nashidja, merrte ndihmë për të shoqin si person i zhdukur. Nuk e di nëse vazhdon të marrë ende para për të, sepse nuk flasim për këtë temë.
18. Pas lufte, por nuk e mbaj mend vitin, vazhdimisht në radio flitej se njerëzit që kanë humbur të afërm gjatë luftës duhej të shkonin tek Zyra për Persona të Zhdukur për t'i raportuar ata. Thuhej se kish ende trupa të paidentifikuar në morgun e Rahovecit. Pas kësaj, ICRC-ja filloi të merrte kampionë gjaku për identifikimin e tyre.
19. Meqë mua më ish vrarë djali Florent gjatë luftës, dhashë gjak për identifikimin e tij. Kurse, djemtë dhe motrat dhanë gjak për identifikimin e Afrimit.
20. Rreth tre muaj pasi u dhanë kampionet e gjakut për identifikim, në fund të gushtit 2005, ICRC-ja e njoftoi në telefon të shoqen e Afrimit, Nashiden se ishin identifikuar pozitivisht eshtrat e tij dhe ajo na njoftoi ne të gjithëve, mua dhe motrat. Të nesërmen, lista e personave të identifikuar doli në televizor.
21. ICRC-ja gjithashtu u kërkoi të afërmeve të shkonin në morgun e Rahovecit për të parë eshtrat e personave të identifikuar, por unë nuk shkova, sepse kisha qenë më parë për identifikimin e eshtrave të tim biri. Kështu që shkoi Nashidja me të birin Vetonin. Shkova vetëm në ceremoninë e varrimit në 30 gusht 2005, që u zhvillua në Pallatin e sportit në Gjakovë. Të gjithë të afërmit e Afrimit ishin të pranishëm gjatë ceremonisë mortore, me përjashtim të Hazbijes, e cila ishte sëmurë në atë kohë. Bashkë me Afrimin, atë ditë u varrosën rreth 13 persona të tjerë.
22. Afrimi u varros në varrezat e Çabratit në Gjakovë. Kur e pyeta të shoqen e Afrimit, Nashiden, ku e kishin gjetur trupin, më tha se e kishin gjetur në Batanicë, në afërsi të Beogradit, në një varr masiv. Nuk e di nga e mori Nashidja informacionin se Afrimi ishte gjetur në një varr masiv në Serbi, por ndoshta nga ICRC-ja. Ndoshta ajo ka dokumenta për këtë, por unë asnjëherë nuk i kërkova të m'i tregonte.
23. Personalisht nuk e kam pyetur ICRC-në se ku ishin gjetur eshtrat e Afrimit, dhe cili kish qenë shkaku i vdekjes së tij, sepse për mua me rëndësi ishte që ju gjetën eshtrat dhe që mundëm ta varrosnim.

Nënshkruar/inicialet:

U015-3481-U015-3486-AT/es

4


të tjerë të pranishëm: nënshkrim

4

Presing

Deklarata e dëshmitarit Agim SYLEJMANI

FVL

VËRTETIMI I DËSHMITARIT

Kjo deklaratë që përbëhet prej 6 faqesh /në origj anglisht/ m'u lexua në gjuhën shqipe dhe është e vërtetë me sa di dhe sa më kujtohet. E kam dhënë këtë deklaratë me vullnet të lirë dhe e di se mund të përdoret gjatë procedurave ligjore para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga 1991, por nuk pranoj të thirrrem për të dhënë dëshmi publike para Gjykatës.

Nënshkruar:

Data: 13.08.2006



Nënshkruar/inicialet:

U015-3481-U015-3486-AT/es



5

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



Deklarata e dëshmitarit Agim SYLEJMANI

VËRTETIMI I PËRKTHYESIT

Unë, Ilir ZIU, vërtetoj se:

1. Jam i kualifikuar dhe i miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish- Jugosllavisë prej Vitit 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Më ka informuar Agim SYLEJMANI se e flet dhe kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e Agim SYLEJMANIT, i cili dukej se e ka dëgjuar dhe kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.
4. Agim SYLEJMANI ka pranuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë, siç i janë përkthyer prej meje, janë të vërteta me sa di dhe sa i kujtohet dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Firma:

Data:

Nënshkruar/inicialet:

U015-3481-U015-3486-AT/es

Ilir ZIU 6

të tjerë të pranishëm: nënshkrim



2



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the Former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

U0161080

**DEKLARATË NGA PERSONI QË JEP DEKLARATË TË
SHKRUAR NË BAZË TË RREGULLIT 92 BIS**

I,

Emr-i/at dhe mbiemr-i/at: ARIM SYL EJMANI

Data dhe Vendi i Lindjes: 19-01-1949 in PONORC

Nr i dokumentit identifikues ose pasaportës: VNRUK ID CARD NO:-1001375551

këtu me këtë konfirmoj, në prani të Zyrtarit Kryesues KAM DOKAISWANY

se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave së/të shkruar/a që unë bëra më 13/08/2006

dhe e/të cila/t tani i është/janë bashkëngjitur kësaj deklarate, është/janë e/të vërtetë/a dhe

e/të saktë/a me sa di dhe me sa besoj.

Më është dhënë gjithashtu një kopje e Rregullit 91 të Rregullores së Procedurës dhe

të Provave të Tribunalit në një gjuhë që unë e kuptoj dhe kuptoj se mund të ndiqem

penalisht për dhënie të dëshmisë së rreme, në qoftë se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave

sime/të mia të shkruar/a nuk është/janë e/të vërtetë/a dhe e/të saktë/a.

Bërë më: 21-04-2007

Në: SHAKOJE, Kosovo

Admir

Nënshkrimi i dëshmitarit

Kam Dokaiswany

Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesues



Rule 92bis